



Orientim për Presidencat e Kuorumeve të Priftërisë Aarone dhe të Klasave të Të Rejave

THIRRUR NGA PERËNDIA

- Çfarë do të thotë për mua që të thirrem nga Perëndia?

JEPUNI SHËRBESË ATYRE TË CILËVE U SHËRBENI

- Si do të arrij t'i njoh e t'i dua të gjithë anëtarët/et e kuorumit ose klasës sime?
MËSONI MË SHUMË: Nëpunësi i lagjes mund të sigurojë një listë të anëtarëve/eve të kuorumit ose klasës.
- Si do ta ndjek shembullin e Shpëtimtarit për dhënien e shërbesës?

PËRGJEGJËSITË ADMINISTRATIVE

- Në çfarë mbledhjesh shkoj dhe cilat mbledhje i planifikoj unë?
MËSONI MË SHUMË PËR: mbledhjet e presidencës së kuorumit ose të klasës dhe këshillat e lagjes për rininë përveç mbledhjeve dhe aktiviteteve të rregullta të kishës (shih *Manuali i Përgjithshëm: Shërbimi në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme*, 10.4.3, 10.4.4, 11.3.4.3, 11.3.4.4, 29.2.9, ChurchofJesusChrist.org).
- Çfarë detyrash administrative kam? Cilat mjete mund të më ndihmojnë?
MËSONI MË SHUMË PËR: rendin e ditës për mbledhjet (shih "[Shembull i Rendit të Ditës për Mbledhjen e Presidencës](#)"), drejtimin e mbledhjeve, delegimin e detyrave, ndjekjen e ecurisë së detyrave dhe përshëndetjen e anëtarëve/eve të kuorumeve ose klasave (shih *Manuali i Përgjithshëm*, kapitulli 4).

PLANIFIKONI MBLEDHJE DHE AKTIVITETE

- Si do të kemi mbledhje lartësuese dhe shpirtërore të së dielës? (Shih udhëzuesin *Eja, Më Ndiq – Për Kuorumet e Priftërisë Aarone dhe Klasat e Të Rejave*.)
MËSONI MË SHUMË TE: EjaMeNdiq.ChurchofJesusChrist.org.
- Si do të kemi shërbim dhe aktivitete përfshirëse dhe me ndikim? (Shih "[Orientime mbi Shërbimin dhe Aktivitetet për Rininë](#)".)
MËSONI MË SHUMË TE: FemijetDheRinia.ChurchofJesusChrist.org.



Informacion për Peshkopatat dhe Udhëheqësit/et në Moshë Madhore të Të Rinjve dhe të Rejave

Peshkopatat kanë përgjegjësinë për t'i orientuar presidencat e sapothirrura të kuorumeve të Priftërisë Aarone dhe të klasave të Të Rejave. Orientimi i një presidencë është një hap i rëndësishëm për t'i ndihmuar udhëheqësit e të rinjve dhe të rejave që t'ia dalin mbanë në thirrjet e tyre.

Burimet vijuese janë sugjerime për t'u ardhur në ndihmë anëtarëve të peshkopatës tekta e orientojnë një presidencë të re ose i japin mësim asaj ekzistuese. Këto burime dhe pyetjet e mëparshme mund të përdoren për të udhëhequr një diskutim të shkurtër për t'i orientuar ose për t'u dhënë mësim presidencave të reja ose atyre ekzistuese në këshillat e lagjes për rininë apo në mjedise të tjera. Sipas drejtimit nga peshkopata, udhëheqësit/et e Të Rinjve dhe të Të Rejave gjithashtu mund t'i shqyrtojnë këto burime në një mbledhje të presidencave të kuorumeve ose klasave.

BURIME PËR ORIENTIMIN

Thirrur nga Perëndia 8–10 MINUTA

"Për të qenë udhëheqës të efektshëm të Kishës, ne duhet të nxjerrim këtë mësim vendimtar: udhëheqja në Kishë nuk ka të bëjë dhe aq me drejtimin e të tjerëve, sesa ka të bëjë me gatishmërinë tonë për t'u drejtuar nga Perëndia" (Diter F. Uhtdorf, "Më i Madhi prej Jush", Ensign ose Liahona, maj 2017, f. 80).

- Presidencat e kuorumeve dhe klasave thirren me anë të zbulësës (shih [Gjoni 15:16](#)).
- Presidencat e kuorumeve të Priftërisë Aarone funksionojnë me çelësat që u jepen kur veçohen presidentët e kuorumeve. Presidencat e klasave të Të Rejave funksionojnë me autoritetin e priftërisë që merret kur veçohen presidencat (shih [Doktrina e Besëlidhje 42:11; 107:5; Nenet e Besimit 1:5; Manuali i Përgjithshëm, 3.4.1](#)).
- Presidencat mbajnë përgjegjësi para Zotit dhe udhëheqësve/eve të Tij (shih [Doktrina e Besëlidhje 104:11–13; Manuali i Përgjithshëm, 4.2.6](#)).
- Presidencat shërbejnë si shembull për anëtarët/et e kuorumeve ose klasave (shih [1 Timoteut 4:12; Alma 17:2–3](#)).

Jepuni Shërbesë Atyre të Cilëve u Shërbeni 5–8 MINUTA

"Ju jeni thirrur për të përfaqësuar Shpëtimtarin. . . . Duart tuaja për t'i ngritur të tjerët [bëhen] njësoj si duart e Tij" (Henry B. Eyring, "Rise to Your Call", Ensign ose Liahona, nëntor 2002, f. 76).

- Numërojeni, mësojuani emrat dhe ushqejini shpirtërisht ata të cilëve u shërbeni (shih [Moroni 6:4](#)).
- Ndihmojini të tjerët ta ndjekin Shpëtimtarin (shih [Manuali i Përgjithshëm, 4.2.3](#)).

Përgjegjësitë Administrative 5–8 MINUTA

"Kjo është mrekullia e këshillave të Kishës: të dëgjojmë njëri-tjetrin dhe të dëgjojmë Shpirtin!" (M. Russell Ballard, "Counseling with Our Councils", Ensign, maj 1994, f. 26).

- Të marrin pjesë në këshillat e lagjes për rininë (shih [Manuali i Përgjithshëm, 29.2.9](#)).
- Të zhvillojnë mbledhje të rregullta të presidencës së kuoromit ose klasës (shih [Manuali i Përgjithshëm, 10.4.3, 11.3.4.3; "Shembull i Rendit të Ditës për Mbledhjen e Presidencës"](#)).
- Të zhvillojnë aftësi udhëheqëse për të kryer punën (shih [Manuali i Përgjithshëm, 4.2](#)).

Planifikoni Mbledhje dhe Aktivitete 5–8 MINUTA

"Çdo aktivitet, çdo mësim, gjithçka që bëjmë në Kishë, të drejtojnë për te Zoti dhe shtëpia e Tij e shenjtë" (Russell M. Nelson, "Personal Preparation for Temple Blessings", Ensign, maj 2001, f. 32).

- Mësojini përgjegjësitë tuaja (shih [Manuali i Përgjithshëm, kapitujt 10–11](#)).
- Planifikoni dhe udhëhiqni sipas drejtimit nga Shpirti (shih [Doktrina e Besëlidhje 43:8–9; 88:119; Moroni 6:9](#)).

UDHËZIME SHITESË

Mundësitë për të zhvilluar aftësi udhëheqëse vazhdojnë në mbledhjet e këshillit të lagjes për rininë dhe mbledhjet e rregullta të presidencave. Për burime për të ndihmuar në këtë përpjekje, shih [Quorum and Class Presidency Resources](#).